



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 938/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Glllogjan kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Besnik Bahtiri nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Komunën e Prishtinës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.938/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Besnik Bahtiri, nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në vendvotimin 1930E-01D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, Besnik Bahtiri nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Komunën e Prishtinës me nr. të listës 8, me të cilën pretendon se në vendvotimin 1930E-01D ka mungesë të votave sipas deklaratave të familjarëve, bashke partiakëve të tij të cilët e kanë votuar. Më tutje, në apel thekson se në bazë të zotimeve ka mbledhur numrat personal të personave me të cilën e kanë votuar, dhe në bazë të dhënave të tij nga 320 vota të cilën mendon se duhet ti figurojnë, në rezultatete ka 284 vota dhe pretendon se ai dhe subjekti i tij është dëmtuar për 36 vota. Pretenduesi i apelit thekson se siç dihet rezultati i ngushtë brenda kandidatëve të subjektit të tij, ai për 9 vota e humb mandatin për tu zgjedhur si anëtar

në Kuvendin Komunal të Komunës së Prishtinës. Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimin 1930E-01D. Si provë ka bashkangjitur një kopje të deklaratës së votuesit të pretenduar, kopjen e dokumentit identifikues (letërnjoftimit) si dhe një kopje të FRK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Besnik Bahtiri, brenda afatit ligjor ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 1930/01D/ në komunën e Prishtinës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi Formularin e bashkangjitur në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se të njëjtit nuk janë bazë e mjaftueshme për të konkluduar se në këtë vendvotim ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve dhe miqve të tij nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidati ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluasi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, një deklaratë duke mos bashkangjitur deklaratë tjera lidhur me pretendimin se i mungojnë 36 vota, e cila

do shërbente si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Besnik Bahtirit, kandidat për Kuvend të Komunës së Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal të Prishtinës në vendvotimin e lartcekur, vlerësohet si i pa bazuar.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.938/2021 më datë 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afiyete Sada Gillogjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.